



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.205/5 prot

Datë 28.02.2025

V E N D I M

Nr. 307/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.02.2025 me

Objekt:

“Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “PAB TIRANA” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur*”, me nr.REF-28066-11-05-2024, me objekt: “*Shporta e Bebes*”, me fond limit 24.849.840 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 06.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane.

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik “PAB TIRANA” SHPK lidhur me shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “PAB TIRANA” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Tirane.
Sheshi “Skenderbej”, Tiranë

Ankimues:

“PAB Tirana” SHPK me NIPT L81829016P dhe adresë: Njesia Bashkiake Nr.6, Rruga e Kavajes, Prona Nr.2/66, ish Kombinati Ushqimor,Tirane.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*.
- I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

- II.1. Në datën 06.11.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit *“E hapur”*, me nr.REF-28066-11-05-2024, me objekt: *“Shporta e Bebes”*, me fond

limit 24.849.840 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 06.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane.

II.2. Në datën 27.12.2024, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave, si më poshtë vijon:

“PAB Tirana” SHPK	19,900,000 lekë, skualifikuar
“Fufarma” SHPK	24,840,000 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “PAB Tirana” SHPK është njoftuar për skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

- 1. Operatori ekonomik nuk permbush kriterin 2.3.3, me operatorin ARTANSA S.P.A Operatori ekonomik ka paraqitur vetem nje marreveshje e cila hyn ne fuqi ne daten 01.01.2025, e cila nuk eshte e vlefshme ne momentin e hapjes se tenderit dhe nuk vertetohet Autorizimi me prodhuesin.*
- 2. Operatori ekonomik nuk permbush kriterin 1.e) te Shtojces nr.8 pasi ka Vertetim OSSHE vetem per nje kontrate, nderkohe qe ne QKB rezultojne tre adresa te ushtrimit te aktivitetit.*
- 3. FIPPI, ADD dhe ARTANSA nuk kane paraqitur certificate ISO 13485:2016, ISO 22716:2007, sipas specifikimeve teknike per artikujt qe do te prokurohen.”*

II.3. Në datën 13.01.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 21.01.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/4998, protokolluar me nr.205/2025 prot, datë 22.01.2025, i operatorit ekonomik “PAB Tirana” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-28066-11-05-2024, me objekt: “Shporta e Bebes”, me fond limit 24.849.840 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 06.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “PAB Tirana” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Shoqëria “PAB Tirana” SHPK me Nipt L81829016P ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit të shpallur nga Bashkia Tiranë, me numrin e referencës REF-28066-11-05-2024, me objekt “Shporta e Bebes”, me fond limit 24,849,840 (njetet e katërmilion e tetëqind e dyzet e nëntë mijë e tetëqind e dyzet) lekë pa TVSH 253,001.83 (dyqind e pesëdhjetë e tremijë e një pikë tetëdhjetë e tre) euro pa TVSH. Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, në datë 06.11.2024 ka

publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE) procedurën e prokurimit e cila ka patur si datë të hapjes datën 06.12.2024.

Në datën 26.12.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. PAB TIRANA 19,900,000 S'kualifikuar

2. FUFARMA 24.840.000 Kualifikuar

Në datën 13.01.2025, Bashkia Tiranë shpalli në sistemin elektronik njoftimin për fillimin e afateve të ankimimit, duke i dhënë mundësi përkatësisht operatorëve ekonomikë që të paraqisnin ankesa për këtë procedurë. Shoqëria “PAB Tirana” SHPK, e cila ka një interes të drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi, si dhe është e prekur nga vendimi për skualifikim, duke u bazuar në Kreun XIV “Ankimi Administrativ” dhe nenet 109, 110, 111, dhe 113 të Ligjit nr. 162/2020 për Prokurimin Publik, si dhe nenet 94 dhe 95 të VKM nr. 285 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, paraqet këtë ankesë brenda afatit ligjor, duke kërkuar rishikimin dhe anulimin e vendimit për skualifikimin e saj. Shoqëria “PAB Tirana” SHPK, me Nipt L81829016P në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi ka patur interes të ligjshëm dhe është drejtpërdrejt i prekur nga vendimmarrja e Autoritetit Kontraktor, bazuar në Kreun XIV Ankimi administrativ nenet 109, 110, 111, 113 të Ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, i ndryshuar si dhe nenet 94, 95 e në vazhdim të VKM nr. 285 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar, paraqet këtë ankesë brenda afatit ligjor, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Autoritetit Kontraktor për skualifikimin e operatorit ekonomik “PAB Tirana” SHPK. “PAB Tirana” SHPK kërkon që autoriteti kontraktor të rishikojë vendimin e skualifikimit dhe të procedojë me vlerësimin e ofertës së tij, për të siguruar një procedurë të drejtë dhe të barabartë konkurrimi, sipas parimeve të përcaktuara në ligjin për prokurimin publik.

Më konkretisht parashtrojmë dhe argumentojmë kundërshtimet tona sa më poshtë:

I. Pretendimi i parë i ngritur nga autoriteti kontraktor për skualifikimin sa më poshtë vijon: Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3; me operatorin ekonomik Artsana S.P.A ka paraqitur vetëm një marrëveshje e cila hyn në fuqi më datë 01.01.2025 e cila nuk është e vlefshme në momentin e hapjes së tenderit dhe nuk vërtetohet Autorizimi me prodhuesin.

Në lidhje me këtë pretendim të ngritur nga autoriteti kontraktor për skualifikimin, e shoqërisë sonë argumentojmë se:

Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, pika 2.3 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti Teknik”, është parashikuar kriteri si më poshtë:

2.3.3 operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim të lëshuar nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar (ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit autorizohet të tregëtojë artikujt/ produktet objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kontratës. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana jonë.

Në plotesim të këtij kriteri kemi paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik akt marrëveshje të lidhur midis operatorit ekonomik "PAB Tirana" SHPK me operatorin ekonomik "Artsana" SPA me datë 15 nëntor 2024. Autoriteti kontraktor ka refuzuar oferten me arsyetimin që marrëveshja nuk është e vlefshme në momentin e hapjes së tenderit.

Për sa më sipër konstatuar, argumentojme dhe prapsojmë si më poshtë:

Referuar dispozitave të Ligjit nr.7850 , datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), Kreu V "Kontratat" është percaktuar qartë se Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike, palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi. Kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës, Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet.

Pra sa më sipërcituar dhe në kuptim të dispozitave midis subjektit ARTSANA S.P.A dhe PAB Tirana shpk është nënshkruar marrëveshja e cila mban datë 15.11.2024. Kjo marrëveshje ka përcaktuar modalitetet dhe vullnetin e palëve për të cilat kane rënë dakord dhe kanë nënshkruar: për furnizimin, shpërndarjen dhe shitjen e produkteve përkatëse sipas termave dhe specifikimeve për çdo produkt nga PAB Tirana shpk, të drejta të cilat i janë dhene dhe njohur prej datës 15.11.2024 nga Artsana SPA, pasi vete marrëveshja në dispoziten e saj të fundit pika 40, paragrafi 2 citon. Në dëshmi të sa më lart, palët e kanë ekzekutuar këtë marrëveshje në datën dhe vitin e shkruar më sipër, e cila përkon me datë 15.11.2024. Në marrëveshje është percaktuar, se kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi me datë 1 janar 2025 në varësi të dispozitave të saj por hyrja në fuqi nënkupton aplikueshmerinë dhe zbatueshmërinë e saj, pra fillimi i procedurave të percaktuara. Nuk nënkupton dhe për më tepër të përcaktojë se kjo marrëveshje është e pavlefshme për periudhën 15.11.2024-31.12.2024, pasi kjo marrëveshje si një veprim juridik i dyanshëm i ka krijuar dhe përmbushur detyrimet e palëve që në datën 15.11.2024 kur është pranuar me shprehjen e vullnetit të plotë dhe nënshkruar nga vetë palët.

Neni 690 e në vijim i KC e definon se kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët dhe se kontrata detyron palët jo vetëm përse është parashikuar në atë por edhe për të gjitha pasojat që rrjedhin prej saj.

Për sa më sipër argumentuar, theksojmë se marrëveshja midis ARTSANA S.P.A dhe PAB Tirana shpk është e vlefshme prej datës 15.11.2024, hyrja në fuqi në datë 01.01.2025 nënkupton bërjen të zbatueshme të saj midis palëve pra fillimin e procedurave sipas termave të references dhe specifikimeve të shprehur në marrëveshje. Data e marrëveshjes dhe e nënshkrimit të saj 15.11.2024 përcakton qartë se kjo marrëveshje ka qenë e vlefshme në momentin e hapjes së procedurës datë 06.12.2024. Me anë të kësaj kontrate, kjo kompani autorizon, si dhe i delegon disa tagre, në lidhje me të drejtën për tregtimin e produkteve të saj, një kompanie tjetër. Në rastin konkret, operatori ekonomik PAB Tirana shpk, disponon një dokument të vlefshëm për pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit. Po ashtu, duke marrë parasysh afatet kohore të percaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik, është e qartë se kontrata që autoriteti kontraktor do të nënshkruajë me operatorin ekonomik për këtë procedurë prokurimi, nuk mund të hyjë në fuqi dhe të marrë efektet e saj para datës 01.01.2025. Kjo vlen

duke llogaritur afatet minimale ligjore, përfshirë 15 ditë të përcaktuara si afat për vlerësimin e ofertave dhe 10 ditët për periudhën e ankimimit të operatorëve ekonomik për këtë procedurë. Pra, kontrata në asnjë rast nuk mund të nënshkruhet para datës 01.01.2025, për të mundësuar fillimin e efekteve të saj teknike dhe financiare, sikundër dhe jemi para faktit që vlerësimi i ofertave nga autoriteti kontraktor është bërë më datë 26.12.2024 dhe deri në këtë moment kontrata akoma nuk është nënshkruar. Theksojme gjithashtu faktin se operatori ekonomik 'PAB Tirana' shpk ka pasur një kontratë të vlefshme deri më 24.11.2024 me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, të përfutur nëpërmjet procedurës së prokurimit me objekt "Shporta e Bebes" të regjistruar me nr. 30735/8 Prot, datë 24.11.2023, me afat 12 muaj. Kjo kontratë është hartuar mbështetur në kontratën e lidhur midis "Artsana" SPA dhe operatorit ekonomik "PAB Tirana" SHPK, e cila është paraqitur si pjesë e dokumentacionit që operatori ekonomik ka dorëzuar në SPE në plotësim të kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë dhe ka pasur vlefshmëri deri në 31.12.2024. Sipas kësaj kontrate, është realizuar furnizimi i autoritetit kontraktor gjatë vitit 2024, për të cilin Bashkia Tiranë ka lëshuar një vërtetim të realizimit me sukses të kontratës. Akoma më tej vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës nga operatori ekonomik, dhe konkretisht neni 83 "Sigurimi i ofertës" i Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenet 36 "Sigurimi i kontratës", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara nga ai në dokumentet e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i operatorit ekonomik duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore.

Sa më sipër, si dhe referuar arsyetimit të AK rezulton e qartë dhe pa asnjë dyshim, se kemi të bëjmë me "justifikime" të paligjshme nga ana e AK me qëllim skualifikimin e shoqërisë sonë. Kërkojmë nga ana juaj rishikimin e vendimit në lidhje me këtë kriter i cili përmbushet plotësisht nga operatori ekonomik "PAB Tirana" SHPK e vërtetuar kjo me dokumentacionin e paraqitur për këtë procedurë prokurimi.

II. Pretendimi i dytë i ngritur nga autoriteti kontraktor për skualifikimin sa më poshtë vijon:

Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 1.e të shtojcës Nr.8, se ka vërtetim OSHE vetëm për një kontratë nderkohe në QKB rezultojnë 3 adresa.

Në shtojcën 8 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit" të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se: e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së ofertës, sipas shtojcës 9. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
 - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
 - c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 - ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
 - d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
 - dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”
- ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 për Prokurimin Publikë, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me kushtetutën.”

Në nenin 82 ‘Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit’ pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.” ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimeve në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës I vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinë, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posacëm në rastin e një organizate jofitimprurëse,

ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; a) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e republikës së shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; 10 h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohej të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një document të lëshuar nga një institucion ose palë e tretë dhe që ka një informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në cdo rast,

autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë Operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.” Referuar pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, i ndryshuar, operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të dorëzojë pranë autoriteteve kontraktore dokumentet provuese të përmbushura me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Arsyeja e skualifikimit për vertetimin e debisë e cila në këtë fazë procedurale duhet të vlerësohet vetëm me deklarimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nuk është i justifikuar ligjërisht referuar bazes ligjore sa më sipër cituar dhe është në kundërshtim me kriteret e vendosura nga vetë autoriteti kontraktor i cili në këtë fazë këtë kriter e kërkon të përmbushur nëpërmjet plotësimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit cka është plotësuar me korrektësi nga ana jone si operator ekonomik. Komisioni i vlerësimit të ofertave në shkelje të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi dhe në kundërshtim me kriteret e vendosura ka skualifikuar mbi një dokument të pakërkuar nga ana e tij në këtë moment procedural.

Theksojme faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i dorëzimit të dokumentacionit provues për përmbushje të formularit të vetëdeklarimit, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar ligji specifik LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Shkeljet e mësipërme, cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike.

Në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscënimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Sa më sipër argumentuar skualifikimi i bërë për një kriter i cili duhet plotësuar në këtë fazë vetëm nëpërmjet deklarimit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit është në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe me vetë kërkesat e autoritetit kontraktor për rrjedhojë kërkojme rishikimin dhe rivlerësim të këtij kriteri nga ana juaj pasi kemi përmbushur kriterin nëpërmjet deklarimit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe duhet të kishim mundësinë të plotësonim dokumentacionin fizik të plotë pas procesit të vlerësimit. Bëjmë me dije se disponojmë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për të gjitha pikat ku ushtrojmë aktivitetin të cilin do e vinim në dispozicion të autoritetit kontraktor në rast të shpalljes fitues me dorëzimin e dokumentacionit fizik. Bashkëngjitur ankesës po vëmë në dispozicion të komisionit të prokurimit publik për verifikim Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

III. Pretendimi i trete i ngritur nga autoriteti kontraktor për skualifikimin sa më poshtë vijon: FIPPI, ADD dhe ARTSANA nuk kanë paraqitur certifikatat ISO 13485: 2016, ISO 22716:2017 sipas specifikimeve teknike për artikujt që do të prokurohen. Në plotësim të shtojces 6 të dokumentave standarte të tenderit, Formulari i specifikimeve teknike operatori ekonomik “PAB Tirana” SHPK ka paraqitur specifikimet teknike të produkteve të cilat ai do të ofrojë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të kërkuar në shtojcën 6 të dokumentat e tenderit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor dhe gjithashtu ka paraqitur certifikatat që përcaktojnë standartet e cilësisë për të gjitha këto produkte. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “1. Specifikimet teknike, sic përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës të parë, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës të dytë të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. cdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët të ekuivalenti i tij/sajë. 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e

përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët iose ekuivalente.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës ibë të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me cdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës iaë të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktorë. Autoriteti kontraktor ka skualifikuar ofertën për mosparaqitje të certifikatave ISO 13485: 2016, ISO 22716:2017 argument teresisht i pajustificuar pasi artikujt e paraqitur nga operatori ynë ekonomik janë prodhime ichiccoë dhe jane në përputhje me standardet ndërkombëtare duke siguruar një nivel të lartë të përputhshmërisë me praktikat dhe kërkesat globale. Kjo është e rëndësishme për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e mallrave të ofruara. Bëjmë me dije se lidhur me oferten teknike, certifikatat janë një dokument i paraqitur ekstra nga ana jonë pasi nuk ishin pjesë e kriterëve kualifikuese sipas DST. Në dokumentat e tenderit nuk është përcaktuar se ky dokumentacion duhet të paraqitet në sistemin e prokurimit elektronik si pjesë e dokumentave kualifikuese të procedures. Thënë kjo autoriteti kontraktor ka vlerësuar ofertën tonë mbi një dokument të pakërkuar nga AK si kriter kualifikues. Sic thamë edhe me lart AK nuk mund të bëjë vlerësim dhe skualifikim mbi kritere qe nuk janë kerkuar ne DST si pjesë e kriterëve për kualifikim.

Operatori ekonomik ka deklaruar dhe provuar me dokumentacion se ploteson te gjitha specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor dhe për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatori ekonomik të ofertojë produkte të cilat janë komform specifikimeve teknike dhe plotësojnë termat funksionalë, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. Fakti i pretenduar nga autoriteti kontraktor se operatori ekonomik nuk ploteson standartet sepse nuk disponon certifikatat ISO 13485: 2016, ISO 22716:2017, është tërësisht i pajustificuar pasi operatori ekonomik ploteson te gjitha standartet nderkombetare ne tregun global dhe për këtë ka paraqitur dhe certifikimet ndërkombëtare të këtyre produkteve. Vlen gjithashtu të theksojmë faktin se këto certifikata të kërkuara nga autoriteti kontraktor nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit pasi certifikata Iso 13485:2016 i perket produkteve mjekesore asnje nga produktet e kerkuara ne “Shporten e Bebes” nuk eshte produkt mjekesor ndersa Panollino Pillo nuk eshte produkt as kozmetik as mjekesor dhe certifikatat si me siper nuk i perkasin ketij produkti pervec certifikates ISO 9001:2015. Përfundimisht konkludojme: 1. Ne kemi ofruar produktet tona te markës “CHICCO”. 2. Absolutisht këto produkte jane në standart shume herë më të lartë nga se është kërkuar, kjo e dokumentuar dhe e provuar me dokumentacionin Teknik të uploaduar në SPE. 3. Ajo cfarë është edhe më e rëndësishme, është fakti se prodhimet Chicco janë një ndër

prodhimet me prestigjioze në tregun ndërkombëtar, dhe produktet janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të kerkuara nga autoriteti kontraktor për të cilat janë paraqitur certifikatat e cilësise se produkteve që tregojnë plotësimin e standarteve ndërkombëtare për këto produkte. 4. Akoma edhe më i rëndësishëm është fakti se nuk mund të skualifikohet një ofertë e cila është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe në përputhje të plotë me kërkesat teknike me qëllim që KVO të kualifikojë një operator tjetër dhe me një cmim afërsisht 5.000.000 lek më të shtrenjta se sa oferta jonë.

5. Ky hap i ndërmarrë nga KVO, është i pajustificueshëm, në shkelje të plotë të vetë qëllimit të ligjit që ka për qëllim të mirë menaxhojë fondet publike dhe në të njëjtën kohë të prokurojë produktet sipas specifikimeve teknike të kerkuara. Argumenti i paraqitur nga autoriteti kontraktor për skualifikimin e ofertës sonë është i pabazuar si në ligj, ashtu edhe në fakte, dhe kërkojmë rishikimin dhe rivlerësimin e këtij vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor. Sic shihet nga arsyetimi i autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës sonë, është e qartë se janë përdorur argumenta dhe arsye të paligjshme, të cilat kanë cuar në skualifikimin e ofertës tonë, duke cenuar interesat tona të ligjshme dhe duke shkelur parimet themelore të ligjit. Ligji specifikisht përcakton se autoriteti kontraktor duhet të sigurojë mirëpërdorimin e fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale. Kemi dyshime të arsyeshme se veprimet e kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) kanë qenë të motivuara për të penguar shpalljen fituese të ofertës më të ulët të operatorit ekonomik 'PAB Tirana' shpk, i cili ka paraqitur ofertën 20% më të ulët se fondi limit. Kjo ka cuar në kualifikimin e një operatori ekonomik tjetër, i cili ka ofruar një cmim vetëm 0,04% më të ulët se vlera e fondit limit. Veprime të tilla janë shkelje të hapura të cdo norme ligjore dhe i shkaktojnë dëm ekonomik buxhetit të institucionit. Në këto kushte, kërkojmë që vendimi të rishikohet për të pasur një rivlerësim të drejtë të procedurës së prokurimit. Ju bejme me dije se do të ndjekim të gjithë hapat ligjore proceduriale administrative dhe jo vetëm me qëllim respektimin e Ligjit..”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 205/1 Prot., datë 23.01.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “PAB Tirana” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 205 prot.

II.6. Në datën 24.02.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me 205/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.3299/2 prot., datë 11.02.2025 me objekt: “Lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Shporta e bebes”, bashkëngjitur informacioni i KSHA-së në lidhje me shqyrtimin e ankesës.

Referuar informacionit të KSHA-së në lidhje me shqyrtimin e ankesës, rezulton se ky komisionin ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, duke argumentuar si vijon:

“[...]

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mori në shqyrtim të gjitha pretendimet e ankimuesit si më poshtë vijon:

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "PAB TIRANA" shpk, se: "Pretendimi i pare i ngritur nga autoriteti koniraktor per skualifikimin si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik nuk permbush kriterin 2.3.3, me operatorin ekonomik Artsana S.P.A ka paraqitur vetem nje marreveshje e cila hyn ne fuqi me datë 01.01.2025 e cila nuk eshte e vlefshme ne momentin e hapjes se tenderit dhe nuk vertetohet Autorizimi me prodhuesin..."

KSHA mori në shqyrtim dokumentin "Akt Marrëveshje" të datës 15.11.2024 me titull "Marrëveshje për shpërndarje me pakicë e shumicë ndërmjet Artsana spa dhe PAB Tirana shpk" si dhe dokumentet standarte të tenderit, Kriteret Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.3, ku është përcaktuar kriteri si më poshtë:

"2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim të lëshuar nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar (ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit autorizohet të tregëtojë artikujt/ produktet objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kontratës. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana jonë".

Nga shqyrtimi i dokumentit "Marrëveshje për shpërndarje me pakicë e shumicë ndërmjet Artsana spa dhe PAB Tirana shpk", lëshuar me datë 15.11.2024 lidhur mes Artsana SPA dhe PAB Tirana sh_p_k, dokument i cili është paraqitur nga ankimuesi në sistemin elektronik të prokurimit, rezulton se në pikën 23 të tij përcaktohet "Afati i marrëveshjes", e më tej në pikën 23.1, është dakortësuar afati i hytjes në fuqi të kësaj marrëveshje konkretisht:

"Në varësi të dispozitave të kësaj marrëveshje, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi nga 1.1.2025 (data te hyrjes në fuqi) dhe do të përfundojë me 31.12.2027 (nuk do të zbatohet rinovim automatik), KSHA verën se në dokumentin akt marrëveshje të dates 15.11.2024, në nenin 23.1 është përcaktuar se data e hyrjes në fuqi të saj eshte data 01.01.2025.

Për shqyrtimin e këtij dokumenti në përputhje me kriteret e vendosura për kualifikim, si dhe legjislacionin për prokurimit publik, KSHA i referohet VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndyshuar, Neni 82, pika 2, në të cilin përcaktohet se:

"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme...",

Për sa më sipër, KSHA, gjykon se referuar marrëveshjes datë 15.11.2024 si dhe legjislacionit të sipërcituar, nga data 06.12.2024 që është data e zhvillimit të tenderit deri me datë 01.01.2025, operator i ankimues nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër që të provojë vlefshmërinë e këtij dokumenti. Aktmarrëveshja e dorëzuar në sistemin elektronik te prokurimit, me anë të së cilës shoqëria PAB Tirana shpk është autorizuar si distributor i shoqërisë "Artsana" SPA mban datën e hyrjes në fuqi 01.01.2025, datë e cila është jashtë afatit të zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke marrë në konsideratë kohën e llogaritur dhe afatet e përfundimit të kësaj procedure, dhe në të tilla kushte KSHA, gjykon se KVO nuk ka mundur ta marrë të mirëqenë këtë

dokument pasi në ditën e hapjes së ofertave datë 06.12.2024, ky dokument nuk ka qenë i vlefshëm, pasi vlefshmëria e tij do të fillonte një muaj më pas.

Në lidhje me këtë fakt ankimuesi pretendon se “... duke marrë parasysh afatet kohore të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik, është e qartë se kontrata që autoriteti kontraktor do të nënshkruajë me operatorin ekonomik për këtë procedurë prokurimi, nuk mund të hyjë në fuqi dhe të marrë efektet e saj para datës 01.01.2025. Kjo vlen duke llogaritur afatet minimale ligjore, përfshirë 15 ditë të përcaktuara si afat për vlerësimin e ofertave dhe 10 ditët për periudhën e ankimit të operatorëve ekonomik për këtë procedurë. Pra, kontrata në asnjë rast nuk mund të nënshkruhet para datës 01.01.2025, për të mundësuar fillimin e efekteve të saj teknike dhe financiare, sikundër dhe jemi para faktit që vlerësimi i ofertave nga autoriteti kontraktor është bërë më datë 26.12.2024 dhe deri në këtë moment kontrata akoma nuk është nënshkruar...

KSHA gjykon se, ky pretendim i ankimuesit nuk qëndron pasi, KVO dhe Autoriteti Kontraktor nuk mund të llogarisin afatet ligjore të vlerësimit dhe të zhvillimit të procesit të prokurimit publik në varësi të hyrjes në fuqi të dokumentacionit që paraqesin operatorët ekonomik në tender. Afatet ligjore të prokurimit nuk mund të përllogariten në varësi të nevojave të operatorëve ekonoinikë, në rastin konkret sipas pretendimit të ankimuesit, KVO dhe Autotiteti Kontraktor duhet të kishin pritur për hyrjen në fuqi të këtij dokumenti dhe pastaj të vijej me zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjen së kontratës përkatëse.

KSHA gjykon se, ankimuesi nuk është në kushtet e llogaritjes së afateve të Autoritetit Kontraktor, sipas dokumenteve që ai vetë disponon, por ka detyrimin të paraqesë dokumentet, të citat duhet të jenë të vlefshme gjatë procesit të zhvillimit të procedurës, në mënyrë që t'i japë garanci dhe siguri Autoritetit Kontraktor që në momentin e shqyrtimit dhe vlerësimit të këtyre dokumenteve. Në rastin konkret, ky dokument nuk ka fuqi vepruese, jo vetëm në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit, por edhe më tej. KVO në këtë rast nuk mund të vlerësojë mbi dokumente të cilave i fillon afati i vlefshmërisë jashtë periudhës së procedurës së prokurimit, e për rrjedhojë KSHA e gjykon të drejtë vendimin e KVO në lidhje me këtë pretendim.

Për sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

-KSHA vijoi me shqyrtimin e pretendimit të ankimuesit të shprehur sipas argumentit nr.2, ku pretendon se:

“...Arsyeja e skualifikimit për vertetimin e debisë e cila në këtë fazë procedurale duhet të vlerësohet vetëm me deklarinë në formularin përmbledhës të vetdeklarimit nuk është i justifikuar ligjërisht referuar bazës ligjore sa më sipër cituar dhe është në kundërshtim me kriteret e vendosura nga vetë autoriteti kontraktor i cili në këtë fazë këtë kriter e kërkon të përmbushur nëpërmjet plotësimit të formularit përmbledhës të vetdeklarimit cka është plotësuar me korrektësi nga ana jone si operator ekonomik.... ” Bëjmë me dije se disponojmë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për të gjitha pikat ku ushtrojmë aktivitetin të cilim do e vinim në dispozicion të autoritetit kontraktor në rast të shpalljes fitues me dorezimin e dokumentacionit fizik. Bashkëngjitur ankesës po vëmë në dispozicion të komisionit të prokurimit publik për verifikim Formularin përmbledhës të vetdeklarimit....”

Përsa më sipër, pasi u shqyrtua pretendimi i ankimuesit, si dhe dokumentacioni i dosjes së prokurimit, KSHA vëren se, operatori ekonomik ankimues është skualifikuar nga kjo procedurë me arsyetimin se: “Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 1.e) të Shtojces nr.8 pasi ka Vertetim OSSHE vetëm për një kontratë, ndërkohë që në QKB rezultojnë tre adresa. “.

Në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 26, pika 2, gërma “e”, përcaktohet se e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyruesit e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

KSHA në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton se, referuar Dokumentave Standarte të Tenderit, në Shtojcën 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, të Pjesa II: Shfaqet e përjashtimit, Gërma A: Deklarata për Përmbushjen e Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit në pikën 1.e), është kërkuar: “Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi”.

Në përmbushje të kësaj kërkesë, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur nga operatori ekonomik është deklaruar, dokumenti lëshuar nga OSHE Group FSHU, adresa e cila si dhe tek lloji i dokumentit është deklaruar se: “Vërtetim debie për operatorët ekonomik për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, për personat juridikë të interesuar për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura si dhe për personat fizikë dhe juridikë të interesuar për procedurat që lidhen me zbatimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit, lidhur me ndërtimet e reja...”

Në VKM-në nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 7, gërma “a”, është parashikuar shprehimisht se: “Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

KSHA gjykon se, deklarimi i operatorit ekonomik “PAB TIRANA” shpk, për përmbushjen e detyrimit për pagimin e energjisë elektrike, duhej të ishte konsideruar i saktë, dhe kriteri të konsiderohej i përmbushur dhe në momentin që do të vije me fazat e mëvonshme të vlerësimit dhe zhvillimit të procedurës, bazuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM-së nr.285/2021, ku përcaktohet se: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”, KVO do të vlerësonte mbi dokumentacionin provues që operatori ekonomik do të paraqiste nëse do të kualifikohet pas vlerësimit të procedurës.

Si rrjedhim, pretendimi i palës ankimuese qëndron.

- Lidhur me pretendimin e ankimuesit se “Autoriteti kontraktor ka skualifikuar ofertën për mosparaqitje të certifikatave ISO 13485. 2016, ISO 22716. 2017 argument teresisht i

pajustifikuar pasi artikujt e paraqitur nga operatori yne ekonomik jane prodhime Chicco dhe jane ne perputhje me standardet nderkombetare, duke siguruar nje nivel te larte te perputhshmerise me praktikat dhe kerkesat globale ... ”; “...Thene kjo autoriteti kontraktor ka vleresuar oferten tone mbi nje dokument te pakerkuar nga AK si kriter kualifikues”.

“...Vlen gjithashtu te theksojmë faktin se keto certifikata te kerkuara nga autoriteti kontraktor nuk kane lidhje me objektin e prokurimit pasi certifikata Iso 13485:2016 i perket produkteve mjekesore, asnje nga produktet e kerkuara ne Shporten e Bebes nuk eshte produkt mjekesor ndersa Panollino Pillo nuk eshte produkt as kozmetik as mjekesor dhe certifikatat si me siper nuk i perkasin ketij produkti pervec certifikates ISO 9001.-2015”.

KSHA, pasi mori në shqyrtim dokumentet standarte të tenderit, vëren se në Shtojcën 6 është përcaktuar:

1. “ Shampo për bebe

Shampoja duhet të jetë në sasinë 300ml.

Shampoja duhet të pastrojë butësisht flokët dhe lëkurën e bebit, të ketë veti qetësuese për lëkurën. Të ruajë vlerat natyrale të pH të lëkurës. Të jetë antialergjike. Të shplahet lehtë dhe të mos irritojë sytë.

Të jetë i testuar dermatologjikisht.

Të mos përmbajë paraben, alkool.

Të përmbajë substanca hidratuese për foshnjën.

Të përmbajë Ekstrakt kamomili dhe/ose proteina gruri.

Të përmbajë certifikim sipas standardeve Europiane EN ISO 13485:2016, ISO 22716:2007, BS EN ISO 9001:2015

2. Krem hidratues për fytyrën dhe trupin për bebe

Kremi hidratues të jetë në sasinë 200ml.

Kremi hidratues të ketë efekt zbutës në lëkurën e bebes. Të sigurojë një hidratim të mire pas dushit.

Të mos përmbajë paraben dhe alkool.

Te mos krijojë irritim të lëkurës dhe të jetë antialergjik i testuar dermatologjikisht.

Të përmbajë Ekstrakt kamomili dhe/ose proteina gruri.

Të përmbajë certifikim sipas standardeve Europiane EN ISO 13485:2016, ISO 22716:2007, BS EN ISO 9001:2015 (ose të përditësuar)

3. Vaj hidratues trupi për bebe

Vaji i trupit të jetë në sasinë 200ml.

Të ketë efekt zbutës dhe hidratues të lëkurës së bebes. Të sigurojë një hidratim të mire pas dushit.

Të respektojë fiziologjinë e lëkurës së bebes.

Të mos përmbajë paraben dhe alkool.

Të jetë i testuar dermatologjikisht.

Të jetë i përshtatshëm për pastrimin dhe trajtimin e koreve të kokës.

Të përmbajë Kamomil dhe/ose Estere emoliente.

Të përmbajë certifikim sipas standardeve Europiane EN ISO 13485:2016, ISO 22716:2007, BS EN ISO 9001:2015 (ose të përditësuar)

4. Krem për ndërrimin e pelenave për bebe

Kremi për ndërrimin e pelenave të jetë në sasinë 175ml.

Të ketë në përbajtje Oksid Zinku, Vaj Kamomili dhe Pantotenol.

Te jetë rezistent ndaj ujit.

Të respektojë fiziologjinë e lëkurës së bebes.

Të mos përmbajë paraben dhe alkool.

Të jetë i testuar dermatologjikisht.

Të përmbajë certifikim sipas standardeve Europiane EN ISO 13485:2016, ISO 22716:2007, BS EN ISO 9001:2015 (ose të përditësuara)

6 Letër e lagur për bebe (pako)

Pako me letra të lagura të ketë jo më pak se 60 fije.

Të jetë me 99% përbajtje uje.

Të jetë letër e biodegradueshme në fibra natyrale.

Të ketë në përbajtje Aloe Vera me origjinë biologjike.

Të mbajë të butë lëkurën e bebit dhe të mos e acarojë.

Letra e lagur duhet të ruajë vlerat natyrale të pH të lëkurës.

Të përmbajë certifikim sipas sipas standardeve Europiane ISO 9001:2015, EN ISO 22716:2008, ISO 13485:2016 (ose të përditësuara).

*Gjithashtu në pikën 2.3.8, të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, shtojca 9, e dokumenteve standarte të tenderit, është përcaktuar se: “Për të garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për furnizimin që do të kryejnë, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë **ISO 9001- 2015** ose i përditësuar (e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).”.*

Referuar Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 79, parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Gjithashtu në VKM-në nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 2 dhe 3, përcaktohet:

“Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Për sa më sipër, KSHA vëren se, plotësimi i kushtit për pajisjen me certifikimin ISO është kërkuar dhe në Shtojcën 6 dhe në Shtojcën 9, të dokumenteve standarte të tenderit, ç'ka ka krijuar konfuzion në vlerësimin e procedurës së prokurimit nga ana e KVO-së.

KSHA gjykon se, kriteret e kualifikimit, duhet të përcaktohen të qarta, të sakta, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me objektin që prokurohet, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë përkundrejt operatorëve ekonomik pjesëmarrës. Përcaktimi i kërkesës për disponimin e certifikimit ISO në Shtojcën 6, të specifikimet teknike si dhe në Shtojcën 9, për disponimin e certifikatës së cilësisë ISO 9001, ka krijuar paqartësi në vlerësimin e procedurës së prokurimit nga ana e KVO- së. KSHA, gjykon se dokumentat standarte të tenderit, duhet të jenë të qarta dhe jo evazive, që të mos krijojnë, paqartësi, konfuzion dhe lexime të ndryshme nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe operatorëve ekonomik pjesëinaiës.

Në rastin konkret, kërkesa për certifikimet ISO EN ISO 22716:2008 dhe ISO 13485:2016, kanë krijuar konfuzion të Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë vlerësimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, pasi nuk është e qartë se në çfarë faze duhet t'i disponojnë operatorët ekonomikë ofertues këto certifikime. Në këtë kuptim, KSHA gjykon se ndodhet në kushtet e hartimit gabim të dokumenteve standarte të tenderit, gjë e cila ka krijuar paqartësi në lidhje me vlerësimin e drejtë nga ana e KVO, pasi gjatë hartimit të kriterëve të vecanta të kualifikimit, si dhe specifikimeve teknike që i vendosen në dispozicion operatorëve ekonomike pjesëmarrës në procedura prokurimi, duhet të merren parasysh elemente të tillë si dobishmëria dhe qartësia në hartimin e tyre, me qëllim shmangien e cdo lloj paqartësie dhe konfuzioni gjatë procesit të vlerësimit të tyre.

Në lidhje me pretendimin e ankimuesit “se keto certifikata të kërkuara nga autoriteti kontraktor nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit pasi certifikata ISO 13485:2016 i përket produkteve mjekësore asnjë nga produktet e kërkuara në Shportën e Bebes nuk është product mjekësor”, KSHA, gjykon se ankimuesi ka pasur kohën e mjaftueshme nga momenti i publikimit të dokumenteve të tenderit, deri në fazën e dorëzimit të ofertave sipas afateve të përcaktuara në ligj për të ushtruar të drejtën e tij për të ankimuar në lidhje me këto pretendime.

Nga shqyrtimi i dosjes së prokurimit, KSHA konstaton se, nga ana e operatorit ekonomik “PAB Tirana” shpk, nuk është dorëzuar asnjë kërkesë për sqarim, në lidhje me dokumentet e tenderit. Nga verifikimi i dosjes së prokurimit, gjithashtu nuk ka patur ankesa në këtë fazë as nga operatorët e tjerë të interesuar.

Në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në 5 (pesë) ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42, i LPP-së.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës në mbështetje të nenit 114, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenit 102, pika 1, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, vendosi të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PAB TIRANA” shpk.”

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “PAB Tirana” SHPK për skualifikimin e tij të padrejtë nga ana e KVO-së, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 24.02.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me 205/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.3299/2 prot., datë 11.02.2025 me objekt: *“Lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Shporta e bebes”, bashkëngjitur informacioni i KSHA-së në lidhje me shqyrtimin e ankesës.*

Referuar informacionit të KSHA-së në lidhje me shqyrtimin e ankesës, rezulton se ky komisionin ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës,

III.1.2. Referuar informacionit të KSHA-së rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PAB Tirana, duke argumentuar si më poshtë:

“KSHA vijoi me shqyrtimin e pretendimit të ankimuesit të shprehur sipas argumentit nr.2, ku pretendon se:

“...Arsyeja e skualifikimit për vertetimin e debisë e cila në këtë fazë procedurale duhet të vleresohet vetëm me deklarinë në formularin përmbledhës të vetdeklarimit nuk është i justifikuar ligjërisht referuar bazës ligjore sa më sipër cituar dhe është në kundërshtim me kriteret e vendosura nga vetë autoriteti kontraktor i cili në këtë fazë këtë kriter e kërkon të përmbushur nëpërmjet plotësimit të formularit përmbledhës të vetdeklarimit cka është plotësuar me korrektësi nga ana jone si operator ekonomik.... ” Bëjmë me dije se disponojmë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për të gjitha pikat ku ushtrojmë aktivitetin të cilim do e vinim në dispozicion të autoritetit kontraktor në rast të shpalljes fitues me dorezimin e dokumentacionit fizik. Bashkëngjitur ankesës po vëmë në dispozicion të komisionit të prokurimit publik për verifikim Formularin përmbledhës të vetdeklarimit. ...”

Përsa më sipër, pasi u shqyrtua pretendimi i ankimuesit, si dhe dokumentacioni i dosjes së prokurimit, KSHA vëren se, operatori ekonomik ankimues është skualifikuar nga kjo procedurë

me arsyetimin se: “Operatori ekonomik nuk permbush kriterin 1.e) te Shtojces nr.8 pasi ka Vertetim OSHEE vetem per nje kontrate, nderkohe qe ne QKB rezultojne tre adresa. “.

Në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 26, pika 2, gërma “e”, përcaktohet se e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrinit e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

KSHA në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton se, referuar Dokumentave Standarte të Tenderit, në Shtojcën 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, te Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Gërma A: Deklarata për Përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit në pikën 1.e), është kërkuar: “Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi”.

Në përmbushje të kësaj kërkesë, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur nga operatori ekonomik është deklaruar, dokumenti lëshuar nga OSHE Group FSHU, adresa ëb si dhe tek lloji i dokumentit është deklaruar se: “Vërtetim debie për operatorët ekonomik për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, për personal juridikë të interesuar për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura si dhe për personat fizikë dhe juridikë të interesuar për procedurat që lidhen me zbatimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit, lidhur me ndërtimet e reja... ”

Në VKM-në nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 7, gërma “a”, është parashikuar shprehimisht se: “Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

KSHA gjykon se, deklarimi i operatorit ekonomik “PAB TIRANA” shpk, për përmbushjen e detyrimit për pagimin e energjisë elektrike, duhej të ishte konsideruar i saktë, dhe kriteri të konsiderohej i përmbushur dhe në momentin që do të vijohej me fazat e mëvonshme të vlerësimit dhe zhvillimit të procedurës, bazuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM-së nr.285/2021, ku përcaktohet se: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ai autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”, KVO do të vlerësonte mbi dokumentacionin provues që operatori ekonomik do të paraqiste nëse do të kualifikohej pas vlerësimit të procedurës. Si rrjedhim, pretendimi i palës ankimuese qëndron.”

III.1.3. Për sa më sipër, referuar nenit 115, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: “2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e

vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”, Komisioni i Prokurimit Publik vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “PAB Tirana” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Komisioni do të vijojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “PAB Tirana” SHPK se: *“Operatori ekonomik nuk permbush kriterin 2.3.3, me operatorin ARTANSA S.P.A Operatori ekonomik ka paraqitur vetem nje marreveshje e cila hyn ne fuqi ne daten 01.01.2025, e cila nuk eshte e vlefshme ne momentin e hapjes se tenderit dhe nuk vertetohet Autorizimi me prodhuesin”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 e dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar përmbushjen e kriterit si më poshtë vijon:

2.3.3 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim të lëshuar nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar (ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit autorizohet të tregëtojë artikujt/ produktet objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kontratës. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana jonë.*

III.2.2. Në shtojcën 6, “Formulari i specifikimeve teknike”, për artikujt objekt ankimimi është parashikuar:

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: *Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme*

për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Shënim: Në kuptim të nenit 36 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar, pika 3/b, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve.

Nëse ekzistojnë standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, AK do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit **SSH/EN**, mbi komformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Specifikimi i parametrave teknik, materialeve etj:

1. Shampo për bebe

Shampoja duhet të jetë në sasinë 300ml.

Shampoja duhet të pastrojë butësisht flokët dhe lëkurën e bebit, të ketë veti qetësuese për lëkurën. Të ruajë vlerat natyrale të pH të lëkurës. Të jetë antialergjike. Të shpohet lehtë dhe të mos irritojë sytë.

Të jetë i testuar dermatologjikisht.

Të mos përmbajë paraben, alkool.

Të përmbajë substanca hidratuese për foshnjën.

Të përmbajë Ekstrakt kamomili dhe/ose proteina gruri.

Të përmbajë certifikim sipas standardeve Europiane EN ISO 13485:2016, ISO 22716:2007, BS EN ISO 9001:2015

2. Krem hidratues për fytyrën dhe trupin për bebe

Kremi hidratues të jetë në sasinë 200ml.

Kremi hidratues të ketë efekt zbutës në lëkurën e bebes. Të sigurojë një hidratim të mire pas dushit.

Të mos përmbajë paraben dhe alkool.

Te mos krijojë irrim të lëkurës dhe të jetë antialergjik i testuar dermatologjikisht.

Të përmbajë Ekstrakt kamomili dhe/ose proteina gruri.

Të përmbajë certifikim sipas standardeve Europiane EN ISO 13485:2016, ISO 22716:2007, BS EN ISO 9001:2015 (ose të përditësuara)

3. Vaj hidratues trupi për bebe

Vaji i trupit të jetë në sasinë 200ml.

Të ketë efekt zbutës dhe hidratues të lëkurës së bebes. Të sigurojë një hidratim të mire pas dushit.

Të respektojë fiziologjinë e lëkurës së bebes.

Të mos përmbajë paraben dhe alkool.

Të jetë i testuar dermatologjikisht.

Të jetë i përshtatshëm për pastrimin dhe trajtimin e koreve të kokës.

Të përmbajë Kamomil dhe/ose Estere emoliente.

Të përmbajë certifikim sipas standardeve Europiane EN ISO 13485:2016, ISO 22716:2007, BS EN ISO 9001:2015 (ose të përditësuara)

4. Krem për ndërrimin e pelenave për bebe

Kremi për ndërrimin e pelenave të jetë në sasinë 175ml.

Të ketë në përmbajtje Oksid Zinku, Vaj Kamomili dhe Pantotenol.

Te jetë rezistent ndaj ujit.

Të respektojë fiziologjinë e lëkurës së bebes.

Të mos përmbajë paraben dhe alkool.

Të jetë i testuar dermatologjikisht.

Të përmbajë certifikim sipas standardeve Europiane EN ISO 13485:2016, ISO 22716:2007, BS EN ISO 9001:2015 (ose të përditësuara)

5. Pelena një përdorimshe për bebe masa 1 (pako)

Pelena të jetë e masës 1.

Pako me pelena të ketë jo më pak se 26 fije.

Materiali përbërës të jetë i butë dhe i përbërë nga pambuku natyral.

Të jenë me teknologjinë “pH comfort” e cila siguron ruajtjen e pH fiziologjik të lëkurës së bebes.

Pelena duhet të ketë kanalet e kapjes së lagështirës, në mënyrë që të mundësohet shpërndarja uniforme e lagështirës dhe të krijohet ndjesia e thatësisë.

Veshja e jashtme duhet të mundësojë ajrosjen e lëkurës së bebes për ta mbajtur të thatë dhe të mbrojtur.

Barrierat anësore duhet të jenë kundër rrjedhjes.

Të jetë e certifikuar nga DNV për “STANDARTI GLOBAL PER PRODUKTET E KONSUMIT – neni 4 – Nëntor 2016 – PERKUJDES PERSONAL DHE SHTEPIAK”

Të jetë e pajisur me Deklaratë Konformiteti e cila vërteton se Gjurma e Karbonit është konform standarteve ISO/TS 14067:2013 (ose e përditësuar).

Te jetë e certifikuar nga GOTS (Global Organic Textile Standard).

Të përmbajë certifikim sipas standardeve Europiane ISO 9001:2015 (ose e përditësuar).

6. Letër e lagur për bebe (pako)

Pako me letra të lagura të ketë jo më pak se 60 fije.

Të jetë me 99% përmbajtje uje.

Të jetë letër e biodegradueshme në fibra natyrale.

Të ketë në përmbajtje Aloe Vera me origjinë biologjike.

Të mbajë të butë lëkurën e bebit dhe të mos e acarojë.

Letra e lagur duhet të ruajë vlerat natyrale të pH të lëkurës.

Të përmbajë certifikim sipas sipas standardeve Europiane ISO 9001:2015, EN ISO 22716:2008, ISO 13485:2016 (ose të përditësuara).

7. Shishe qelqi me kokë biberoni

Biberoni të jetë i përshtatshëm për ushqyerjen e bebes në moshën 0 – 6 muaj.

Materiali i trupit të biberonit të jetë 100% qelq dhe i dozuar në ml (120ml).

Materiali i kokës të jetë latex i butë.

Të ketë sistem ajrimi anti-kolik.

Të ketë sensor të ndjeshëm ndaj temperaturës, për të siguruar përgatitjen e qumshtit/lëngjeve në temperaturën e duhur.

Materiali të jetë rezistent ndaj nxehtësisë në mënyrë që të sterilizohet pa problem

Duhet të jetë higjienik dhe i sigurt.

Koka e biberonit duhet të jetë me kënd që të lejojë pozicionimin perfekt të gojës si dhe frymëmarrjen gjatë ushqimit.

8. Biberon fallco

Biberon fallco i pajisur me një unazë, lehtësisht i përdorshëm.

I përshtatshëm për fëmijët e moshave 0 – 6 muaj.

Materiali duhet të jetë 100% silikon i butë.

Të jetë material silikon edhe nga jashtë për të garantuar kontakt delikat me fytyrën e fëmijës.

Të suportojë ekuilibrin e mirë thithje – frymëmarrje që foshnja të mos rrezikohet nga bllokimi.

9. Lodër për dhëmbët

Lodra për dhëmbët duhet të jetë e përshtatshme për fëmijët e moshës 3 muaj +.

Lodra duhet të jetë e lehtë për tu kapur dhe menaxhuar nga fëmija.

Duhet ta ruajë temperaturën e ftohtë më gjatë në mënyrë që të ofrojë lehtësim të mishrave të dhëmbëve tek fëmija.

Duhet të jetë me ngjyra që tërheqin vëmendjen e fëmijës dhe të stimulojë shqisat e fëmijës.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Përshkrimi dhe analiza sociale e projektit

Bashkia e Tiranës me qëllim ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave që i ngarkon legjislacioni në fuqi, për realizimin e shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë, me qëllim për të ndihmuar nënat e reja në ditët e para pas lindjes synon realizimin e projektit “Shporta e Bebes”.

Bashkia e Tiranës referuar programit të Kujdesit Social dhe të Edukimit, ka në fokus të saj edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve brenda standardeve të miratuara si një nga objektivat strategjike prioritarë. Fëmijët duket se janë kategoria më e ekspozuar ndaj rreziqeve për shkak të moshës, të pjekurisë fizike dhe intelektuale, prandaj ato kanë nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të veçantë nga familja, shoqëria dhe institucionet shtetërore. Në këtë kuadër kjo politikë

ne nivel vendor synon hartimin dhe aplikimin e projekteve që sigurojnë mbrojtje dhe kujdes të veçantë për fëmijët, në zbatim të standardeve kombëtare të miratuara dhe ato europiane, nëpërmjet fuqizimit dhe mbështetjes së vazhdueshme të gjithë familjeve të reja të Bashkisë Tiranë. Gjithashtu, referuar nenit 24 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar përcaktohet se Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Meqënëse për nënat e reja ardhja në jetë e të porsalindurit është një fazë tranzitore e cila, si dhe nisur nga fakti që kjo periudhë shoqërohet ndryshime fizike e psikologjike, plot me sfida dhe vështirësi në familje, vlerësojmë që prindërve të rinj të cilët kanë sjellë në jetë fëmijën, ti mundësohet edhe mbështetje materiale nëpërmjet ofrimit të një shporte me produktet kryesore imediate që nevojiten për një foshnjë të porsalindur. Kjo inisiativë ka në fokus të saj realizimin me sukses të objektivave dhe përgjegjësi që i ngarkon legjislacioni në fuqi, njësi të qeverisjes vendore, e më konkretisht ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, në kuadër të kujdesit dhe mbrojtjes që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës, duke synuar zgjerimin e fushës së mbështetjes sociale edhe në kujdesin parësor ndaj fëmijeve të porsalindur.

Gjithashtu referuar ligjit nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e konventës për të drejtat e fëmijës”, shtetet palë angazhohen të respektojnë dhe t’i sigurojnë çdo fëmijë që përfshihet në juridiksionin e tyre mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke marrë të gjitha masat e mundshme në mënyra të ndryshme për të siguruar zhvillimin e tyre. Politikat e hartuara për përmbushjen e këtij qëllimi kanë në fokus interesin më të lartë të fëmijës.

Projekti “Shporta e bebes”, vjen si një risi në jetën sociale të komunitetit të Tiranës, duke synuar mbështetjen e nënës së re me qëllim aftësimin për ruajtjen e mirëqenies fizike, emocionale dhe psikologjike dhe mësimin e shprehive për t’u kujdesur për të porsalindurin. Synimi i kësaj shporte është mbështetja në ditët e para të lindjes, me produktet e nevojshme dhe të domosdoshme për çdo nënë e cila ka sjellë në jetë të një bebe.

Për sa më lart, me qëllim për të ndihmuar nënat e reja në ditët e para pas lindjes, Bashkia Tiranë miratoi projektin “Shporta e bebes”, e cila përmban një shportë produktesh të nevojshme për fëmijën e sapo ardhur në jetë.

Qëllimi i projektit është mbështetjen e nënës së re me qëllim aftësimin për ruajtjen e mirëqenies fizike, emocionale dhe psikologjike dhe mësimin e shprehive për t’u kujdesur për të porsalindurin. Synimi i kësaj shporte është mbështetja në ditët e para të lindjes, me produktet e nevojshme dhe të domosdoshme për çdo nënë e cila ka sjellë në jetë të një bebe.

Objektivat e projektit janë:

- Sigurimi i mbrojtjes së veçantë të fëmijës, duke synuar zgjerimin e fushës së mbështetjes sociale edhe në kujdesin parësor ndaj fëmijeve të porsalindur
- Sigurimi i kujdesit të nevojshëm për mirëqenien dhe zhvillimin e çdo fëmije në Bashkinë e Tiranës.

- Mbështetja e nënës së re me qëllim aftësimin për ruajtjen e mirëqenies fizike, emocionale dhe psikologjike dhe mësimin e shprehive për t'u kujdesur për të porsalindurin

Përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij projekti do të jenë të porsalindurit në martenitetin publik “Mbretëresha Geraldine” ose “Koço Glozheni”, prindi/prindërit e të cilëve janë me vendbanimin të përhershëm në Tiranë.

Rezultatet e pritshme të këtij projekti janë:

- Aplikimi i skemave të reja për mbrojtje dhe kujdes të veçantë për fëmijët.
- Fuqizim dhe mbështetje e vazhdueshme të gjitha familjet e reja të Bashkisë Tiranë.
- Reduktimi i ankthit të nënës së re në ditët e para pas lindjes

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Baza materiale për një “Shportë bebe” me qëllim përmbushjen e objektivave të këtij projekti, përmban një shportë produktesh të nevojshme për fëmijën e sapo ardhur në jetë, si më poshtë:

1 Shampo për bebe

1 Krem hidratues për fytyrën dhe trupin për bebe

1 Vaj hidratues trupit për bebe

1 Krem për ndërrimin e pelenave për bebe

1 Pako Pelena një përdorimshe masa 1

1 Pako Letra të lagura për bebe

1 Shishe qelqi me kokë biberoni

1 Biberon fallco

1 Lodër për dhëmbët

Operatorët ekonomik ofertues duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike për produktet përbërese të shportës së bebes.

Shpërndarja e “Shportës së bebes” do të realizohet, bazuar në numrin e lindjeve të regjistruara nga punonjësit e gjendjes civile pranë institucioneve shëndetësore ku foshnjat kanë lindur. Bashkia Tiranë për çdo përfitues që paraqitet për tërheqjen sipas kriterëve të mësipërme do të dhurojnë shportën.

Projekti “Shporta e bebes” e konceptuar si Shporta e bebes” do të përfitohet nga prindi/prindërit nga dita e lindjes së fëmijës.

1. Malli do të merret në dorëzim në magazinën Operatorit Ekonomik Fitues.
2. Produktet objekt prokurimi për një “Shportë bebe”, do të jenë të ambalazhuar në një shportë kashte ose kuti/ “çantë” paketimi dekorative.
3. Procesi i shpërndarjes do të menaxhohet nga strukturat e Bashkisë Tiranë

Detajimi i procedurave operacionale të zbatimit të tij, me qëllim realizimin dhe zbatimin e projektit “Shporta e Bebes” si dhe përmbylljen me efikasitet të këtij projekti, do të përcaktohen në kontratën e lidhur ndërmjet Bashkisë së Tiranës dhe subjektit të shpallur fitues për realizimin e tij.

Në shtojcën 7 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, është parashikuar si vijon:

Shtojca 7.**Sasia e mallit që kërkohet:**

Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia
1	Shampo për bebe	6000
2	Krem hidratues për fytyrë dhe trupin për bebe	6000
3	Vaj hidratues trupi për bebe	6000
4	Krem për ndërrimin e pelenave për bebe	6000
5	Pelena një përdorimshe për bebe masa 1 (pako)	6000
6	Letër e lagur për bebe (pako)	6000
7	Shishe qelqi me kokë biberoni	6000
8	Biberon fallco	6000
9	Lodër për dhëmbët	6000

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Shampo për bebe	6000	prindi/ prindërit nga dita e lindjes së fëmijës.	1 vit sipas kërkesave të AK
2	Krem hidratues për fytyrë dhe trupin për bebe	6000	prindi/ prindërit nga dita e lindjes së fëmijës.	1 vit sipas kërkesave të AK
3	Vaj hidratues trupi për bebe	6000	prindi/ prindërit nga dita e lindjes së fëmijës.	1 vit sipas kërkesave të AK
4	Krem për ndërrimin e pelenave për bebe	6000	prindi/ prindërit nga dita e lindjes së fëmijës.	1 vit sipas kërkesave të AK
5	Pelena një përdorimshe për bebe masa 1 (pako)	6000	prindi/ prindërit nga dita e lindjes së fëmijës.	1 vit sipas kërkesave të AK
6	Letër e lagur për bebe (pako)	6000	prindi/ prindërit nga dita e lindjes së fëmijës.	1 vit sipas kërkesave të AK
7	Shishe qelqi me kokë biberoni	6000	prindi/ prindërit nga dita e lindjes së fëmijës.	1 vit sipas kërkesave të AK
8	Biberon fallco	6000	prindi/ prindërit nga dita e lindjes së fëmijës.	1 vit sipas kërkesave të AK
9	Lodër për dhëmbët	6000	prindi/ prindërit nga dita e lindjes së fëmijës.	1 vit sipas kërkesave të AK

Afatet e lëvrimit dhe vendi i dorëzimit të mallit: Nga data e nënshkrimit të kontratës operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe në datat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor, brenda 1 viti/12 muaj.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa

cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.5. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 5 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave. 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPPsë, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

Në nenin 82, pika 2, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme...”

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.7. Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit të shoqërisë “PAB Tirana” SHPK, ankimuesi pretendon se: *“Pretendimi i parë i ngritur nga autoriteti kontraktor për skualifikimin sa më poshtë vijon: Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3; me operatorin ekonomik Artsana S.P.A ka paraqitur vetëm një marrëveshje e cila hyn në fuqi më datë 01.01.2025 e cila nuk është e vlefshme në momentin e hapjes së tenderit dhe nuk vërtetohet Autorizimi me prodhuesin.*

Në lidhje me këtë pretendim të ngritur nga autoriteti kontraktor për skualifikimin, e shoqërisë sonë argumentojmë se: Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, pika 2.3 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti Teknik”, është parashikuar kriteri si më poshtë: 2.3.3 operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim të lëshuar nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar (ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit autorizohet të tregëtojë artikujt/ produktet objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kontratës. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana jonë”. Në plotësim të këtij kriteri kemi paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik akt marrëveshje të lidhur midis operatorit ekonomik “PAB Tirana” SHPK me operatorin ekonomik “Artsana” SPA me datë 15 nëntor 2024. Autoriteti kontraktor ka refuzuar ofertën me arsyetimin që marrëveshja nuk është e vlefshme në momentin e hapjes së tenderit. Për sa më sipër konstatuar, argumentojmë dhe prapsojmë si më poshtë: Referuar dispozitave të Ligjit nr.7850 , datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Kreu V “Kontratat” është përcaktuar qartë se Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë,

ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike, palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi. Kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës, Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet. Pra sa më sipërcituar dhe në kuptim të dispozitave midis subjektit ARTSANA S.P.A dhe PAB Tirana shpk është nënshkruar marrëveshja e cila mban datë 15.11.2024. Kjo marrëveshje ka përcaktuar modalitetet dhe vullnetin e palëve për të cilat kanë rënë dakord dhe kanë nënshkruar: për furnizimin, shpërndarjen dhe shitjen e produkteve përkatëse sipas termave dhe specifikimeve për çdo produkt nga PAB Tirana shpk, të drejta të cilat i janë dhënë dhe njohur prej datës 15.11.2024 nga Artsana SPA, pasi vete marrëveshja në dispoziten e saj të fundit pika 40, paragrafi 2 citon. Në dëshmi të sa më lart, palët e kanë ekzekutuar këtë marrëveshje në datën dhe vitin e shkruar më sipër, e cila përkon me datë 15.11.2024. Në marrëveshje është përcaktuar, se kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi me datë 1 janar 2025 në varësi të dispozitave të saj por hyrja në fuqi nënkupton aplikueshmërinë dhe zbatueshmërinë e saj, pra fillimi i procedurave të përcaktuara. Nuk nënkupton dhe për më tepër të përcaktojë se kjo marrëveshje është e pavlefshme për periudhën 15.11.2024-31.12.2024, pasi kjo marrëveshje si një veprim juridik i dyanshëm i ka krijuar dhe përmbushur detyrimet e palëve që në datën 15.11.2024 kur është pranuar me shprehjen e vullnetit të plotë dhe nënshkruar nga vetë palët.

Neni 690 e në vijim i KC e definon se kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët dhe se kontrata detyron palët jo vetëm përsa është parashikuar në atë por edhe për të gjitha pasojat që rrjedhin prej saj. Për sa më sipër argumentuar, theksojmë se marrëveshja midis ARTSANA S.P.A dhe PAB Tirana shpk është e vlefshme prej datë 15.11.2024, hyrja në fuqi në datë 01.01.2025 nënkupton bërjen të zbatueshme të saj midis palëve pra fillimin e procedurave sipas termave të references dhe specifikimeve të shprehur në marrëveshje. Data e marrëveshjes dhe e nënshkrimit të saj 15.11.2024 përcakton qartë se kjo marrëveshje ka qenë e vlefshme në momentin e hapjes së procedurës datë 06.12.2024. Me anë të kësaj kontrate, kjo kompani autorizon, si dhe i delegon disa tagre, në lidhje me të drejtën për tregtimin e produkteve të saj, një kompanie tjetër. Në rastin konkret, operatori ekonomik PAB Tirana shpk, disponon një dokument të vlefshëm për pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit. Po ashtu, duke marrë parasysh afatet kohore të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik, është e qartë se kontrata që autoriteti kontraktor do të nënshkruajë me operatorin ekonomik për këtë procedurë prokurimi, nuk mund të hyjë në fuqi dhe të marrë efektet e saj para datës 01.01.2025. Kjo vlen duke llogaritur afatet minimale ligjore, përfshirë 15 ditë të përcaktuara si afat për vlerësimin e ofertave dhe 10 ditët për periudhën e ankimit të operatorëve ekonomik për këtë procedurë. Pra, kontrata në asnjë rast nuk mund të nënshkruhet para datës 01.01.2025, për të mundësuar fillimin e efekteve të saj teknike dhe financiare, sikundër dhe jemi para faktit që vlerësimi i ofertave nga autoriteti kontraktor është bërë më datë 26.12.2024 dhe deri në këtë moment kontrata akoma nuk është nënshkruar. Theksojmë gjithashtu faktin se operatori ekonomik 'PAB Tirana' shpk ka pasur një kontratë të vlefshme deri më 24.11.2024 me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, të përfutur nëpërmjet procedurës së prokurimit me objekt "Shporta e Bebes" të regjistruar me nr. 30735/8 Prot, datë 24.11.2023, me

afat 12 muaj. Kjo kontratë është hartuar mbështetur në kontratën e lidhur midis “Artsana” SPA dhe operatorit ekonomik “PAB Tirana” SHPK, e cila është paraqitur si pjesë e dokumentacionit që operatori ekonomik ka dorëzuar në SPE në plotësim të kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë dhe ka pasur vlefshmëri deri në 31.12.2024. Sipas kësaj kontrate, është realizuar furnizimi i autoritetit kontraktor gjatë vitit 2024, për të cilin Bashkia Tiranë ka lëshuar një vërtetim të realizimit me sukses të kontratës. Akoma më tej vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës nga operatori ekonomik, dhe konkretisht neni 83 “Sigurimi i ofertës” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara nga ai në dokumentet e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i operatorit ekonomik duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore. Sa më sipër, si dhe referuar arsyetimit të AK rezulton e qartë dhe pa asnjë dyshim, se kemi të bëjmë me “justifikime” të paligjshme nga ana e AK me qëllim skualifikimin e shoqërisë sonë. Kërkojmë nga ana juaj rishikimin e vendimit në lidhje me këtë kriter i cili përmbushet plotësisht nga operatori ekonomik “PAB Tirana” SHPK e vërtetuar kjo me dokumentacionin e paraqitur për këtë procedurë prokurimi.”.

III.2.8. Në përgjigjen e dhënë ankesës së paraqitur, autoriteti kontraktor argumenton si vijon: “Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “PAB TIRANA” shpk, se: “Pretendimi i pare i ngritur nga autoriteti kontraktor për skualifikimin si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3, me operatorin ekonomik Artsana S.P.A ka paraqitur vetëm një marrëveshje e cila hyn në fuqi me datë 01.01.2025 e cila nuk është e vlefshme në momentin e hapjes së tenderit dhe nuk vërtetohet Autorizimi me prodhuesin...”

KSHA mori në shqyrtim dokumentin “Akt Marrëveshje” të datës 15.11.2024 me titull “Marrëveshje për shpërndarje me pakicë e shumicë ndërmjet Artsana spa dhe PAB Tirana shpk” si dhe dokumentet standarte të tenderit, Kriteret Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.3, ku është përcaktuar kriteri si më poshtë:

“2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim të lëshuar nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar (ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit autorizohet të tregëtojë artikujt/ produktet objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kontratës. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana jonë”.

Nga shqyrtimi i dokumentit “Marrëveshje për shpërndarje me pakicë e shumicë ndërmjet Artsana spa dhe PAB Tirana shpk”, lëshuar me datë 15.11.2024 lidhur mes Artsana SPA dhe PAB Tirana sh_p_k, dokument i cili është paraqitur nga ankimuesi në sistemin elektronik të prokurimit, rezulton se në pikën 23 të tij përcaktohet “Afati i marrëveshjes”, e më tej në pikën 23.1, është dakortësuar afati i hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje konkretisht:

“Në varësi të dispozitave të kësaj marrëveshje, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi nga 1.1.2025 (data e hyrjes në fuqi) dhe do të përfundojë me 31.12.2027 (nuk do të zbatohet rinovim automatik), KSHA verën se në dokumentin akt marrëveshje të datës 15.11.2024, në nenin 23.1 është përcaktuar se data e hyrjes në fuqi të saj është data 01.01.2025.

Për shqyrtimin e këtij dokumenti në përputhje me kriteret e vendosura për kualifikim, si dhe legjislacionin për prokurimit publik, KSHA i referohet VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 82, pika 2, në të cilin përcaktohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme...” Për sa më sipër, KSHA, gjykon se referuar marrëveshjes datë 15.11.2024 si dhe legjislacionit të sipërcituar, nga data 06.12.2024 që është data e zhvillimit të tenderit deri me datë 01.01.2025, operatori ankimues nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër që të provojë vlefshmërinë e këtij dokumenti. Aktmarrëveshja e dorëzuar në sistemin elektronik të prokurimit, me anë të së cilës shoqëria PAB Tirana shpk është autorizuar si distributor i shoqërisë “Artsana” SPA, mban datën e hyrjes në fuqi 01.01.2025, datë e cila është jashtë afatit të zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke marrë në konsideratë kohën e llogaritur dhe afatet e përfundimit të kësaj procedure, dhe në të tilla kushte KSHA, gjykon se KVO nuk ka mundur ta marrë të mirëqenë këtë dokument pasi në ditën e hapjes së ofertave datë 06.12.2024, ky dokument nuk ka qenë i vlefshëm, pasi vlefshmëria e tij do të fillonte një muaj më pas. Në lidhje me këtë fakt ankimuesi pretendon se “... duke marrë parasysh afatet kohore të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik, është e qartë se kontrata që autoriteti kontraktor do të nënshkruajë me operatorin ekonomik për këtë procedurë prokurimi, nuk mund të hyjë në fuqi dhe të marrë efektet e saj para datës 01.01.2025. Kjo vlen duke llogaritur afatet minimale ligjore, përfshirë 15 ditë të përcaktuara si afat për vlerësimin e ofertave dhe 10 ditët për periudhën e ankimimit të operatorëve ekonomik për këtë procedurë. Pra, kontrata në asnjë rast nuk mund të nënshkruhet para datës 01.01.2025, për të mundësuar fillimin e efekteve të saj teknike dhe financiare, sikundër dhe jemi para faktit që vlerësimi i ofertave nga autoriteti kontraktor është bërë më datë 26.12.2024 dhe deri në këtë moment kontrata akoma nuk është nënshkruar...”.

KSHA gjykon se, ky pretendim i ankimuesit nuk qëndron pasi, KVO dhe Autoriteti Kontraktor nuk mund të llogarisin afatet ligjore të vlerësimit dhe të zhvillimit të procesit të prokurimit publik në varësi të hyrjes në fuqi të dokumentacionit që paraqesin operatorët ekonomik në tender. Afatet ligjore të prokurimit nuk mund të përllogariten në varësi të nevojave të operatorëve ekonomikë, në rastin konkret sipas pretendimit të ankimuesit, KVO dhe Autoriteti Kontraktor duhet të kishin pritur për hyrjen në fuqi të këtij dokumenti dhe pastaj të vijohej me zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjes së kontratës përkatëse.

KSHA gjykon se, ankimuesi nuk është në kushtet e llogaritjes së afateve të Autoritetit Kontraktor, sipas dokumenteve që ai vetë disponon, por ka detyrimin të paraqesë dokumentet, të citat duhet të jenë të vlefshme gjatë procesit të zhvillimit të procedurës, në mënyrë që t'i japë garanci dhe siguri Autoritetit Kontraktor që në momentin e shqyrtimit dhe vlerësimit të këtyre dokumenteve. Në rastin konkret, ky dokument nuk ka fuqi vepruese, jo vetëm në kohën e zhvillimit të

procedurës së prokurimit, por edhe më tej. KVO në këtë rast nuk mund të vlerësojë mbi dokumente të cilave i fillon afati i vlefshmërisë jashtë periudhës së procedurës së prokurimit, e për rrjedhojë KSHA e gjykon të drejtë vendimin e KVO në lidhje me këtë pretendim.

Për sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.”

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi ofertën e paraqitur në SPE nga shoqëria ankimuese “PAB Tirana” SHPK, ku rezulton se, lidhur me arsyen e parë të skualifikimit, objekt ankimimi, është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Marrëveshje për shpërndarje me pakicë dhe shumicë, e lidhur në datën 15.11.2024 ndërmjet kompanisë “Artsana” SpA dhe shoqërisë “PAB Tirana” SHPK (distributor). Në pikën 23. “Afati i marrëveshjes”, nënpika “23.1”, është përcaktuar si vijon:

23.1 Në varësi të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi nga 1 janari 2025 (Data e hyrjes në fuqi) dhe do të përfundojë më 31 dhjetor 2027. Nuk do të zbatohet rinovim automatik.

III.2.10. Për sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat, që duhet të ndiqen për për zgjedhjen e ofertës më të mirë në kuptim të këtij ligji. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*. Në këtë kuadër KPP gjykon, se marrëveshja e mësipërme nuk përmbush kriteret e kualifikimit pasi hyn në fuqi në datën 01.01.2025, ndërkohë që procedura e prokurimit në fjalë është zhvilluar në datën 06.12.2024, pra që është edhe data e fundit e paraqitjes së ofertave në SPE. Operatori ekonomik “PAB Tirana” SHPK, në momentin e hapjes së ofertave më datë 06.12.2025, ka dorëzuar një dokument i cili nuk kishte fuqi vepruese edhe për 25 ditë në vijim, deri në datën 31.12.2024, duke rënë ndesh me parashikimit e nenit 77 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, sipas të cilit: “*Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose*

enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. Pra Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në datën e hapjes së ofertave, dokumenti “*Marrëveshje për shpërndarje me pakicë dhe shumicë*” e lidhur ndërmjet kompanisë “Artsana” SpA dhe shoqërisë “PAB Tirana” SHPK nuk është i vlefshëm. Në momentin e paraqitjes së ofertës, operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, dokumentacion i cili duhet të plotësojë të gjitha kriteret e përcaktuara në ligj. Fakti që marrëveshja bëhet e zbatueshme 25 ditë pas hapjes së ofertave, penalizon subjektin, çka sjell skualifikimin e tij nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 3 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “*Për prokurimin publik*”, ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit për përmbushjen e kriterit 2.3.3, nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “PAB Tirana” SHPK se: “*FIPPI, ADD dhe ARTANSA nuk kane paraqitur certifikate ISO 13485:2016, ISO 22716:2007, sipas specifikimeve teknike per artikujt qe do te prokurohen.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.8 e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon:

“2.3.8 Për të garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për furnizimin që do të kryejnë, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë ISO 9001- 2015 ose i përditësuar (e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO).

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”

- ☐ Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- ☐ Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

III.3.2 Në nenin Neni 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.3.3. Në nenin Neni 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkojë, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.3.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit sikurse përmendëm edhe më sipër, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar shprehimisht se *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë ISO 9001- 2015 ose i përditësuar*. Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit të plotësojnë kërkesën për certifikate ISO 13485:2016, ISO 22716:2007, kërkesë e cila do të përbënte detyrim për t'u përmbushur nga ofertuesit.

Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cenon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik "PAB Tirana" SHPK qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: “Vlen gjithashtu të theksojmë faktin se këto certifikata të kërkuara nga autoriteti kontraktor nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit pasi certifikata Iso 13485:2016 i perket produkteve mjekesore asnjë nga produktet e kerkuara ne “Shporten e Bebes” nuk eshte produkt mjekesor ndersa Panollino Pillo nuk eshte produkt as kozmetik as mjekesor dhe certifikatat si me siper nuk i perkasin ketij produkti [...]”, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuara nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e

Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PAB Tirana” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr.REF-28066-11-05-2024, me objekt: “Shporta e Bebes”, me fond limit 24.849.840 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 06.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me konstatimet e KPP-së në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PAB Tirana” SHPK
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiovent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

